



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK KORÇË

VENDIM

Nr. 67 datë 26-06-2025

PËR MIRATIMIN E EMËRIMIT TË AUDITUESVE LIGJORË TË AUTORIZUAR TË SHA TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA – PERIME KORÇË, TË MBLEDHJES SË DATËS 26-QERSHOR TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me Këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe Emërimin e audituesve ligjorë të autorizuar të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 24.06.2025, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 5 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 97,pika 2 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë të miratuar me VKM nr. 80, datë 30.07.2020

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë Audituesve Ligjorë të Miratuar Z/Znj. Vasil Xeqa dhe Z/Znj. Ilida Ikonomi, për të ndjekur Aktivitetin dhe Ecurinë e SHA Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Korçë për vitin 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 21 Vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur në datë 27-06-2025

